

VENDIM
Nr. 836, datë 18.9.2013

PËR PËRCAKTIMIN E MASAVE PËR FUNKSIONIMIN E PËRKOHSHËM TË MINISTRIVE TË REJA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpenzimet më të domosdoshme për funksionimin e kabineteve të institucioneve të reja, përkatësisht: të Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore dhe Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, deri ditën e hyrjes në fuqi të ligjit ndryshues të buxhetit të vitit 2013, të kryhen dhe të përballohen nga buxheti i aparatit të Kryeministrit, miratuar për këtë vit.

2. Fondet për shpenzimet e domosdoshme të përdoren për “Shpenzime personeli” për stafin shtesë të kabineteve, gjithsej 22 veta, të cilët përballohen nga numri i punonjësve rezervë të Këshillit të Ministrave dhe për shpenzime të tjera operative.

3. Ngarkohen aparati i Kryeministrit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama